

Kiti Jurica – Korda

# Krismat në parlament





## Pyetja kyçe

### Pse u vra Stjepan Radiq?

#### Tema

Moduli është për vrasjen e Stjepan Radiqit dhe anëtarëve të PKD-së (Partisë Kroate të Drejtësisë) në Kuvendin Popullor në Beograd më 20 korrik 1928.

Kontroversa e kësaj teme është se kjo vrasje nga shumica e kroatëve u përjetua si mënyrë me anë të së cilës regjimi i kohës ballafaqohej me partinë më të fuqishme kroate dhe presidentin e saj shumë të popullarizuar. Teza që bëhet fjalë për ngjarje të paramenduar nuk është dëshmuar, por mendimi se kjo ka qenë vrasje e organizuar ka mbetur në mesin e kroatëve, para se të shfaqet versioni zyrtar se bëhet fjalë për akt të rastësishëm të deputetit “të luajtur mendsh” Punisha Radiq.

Duke e marrë parasysh atë që vrasja ndodhi në Kuvendin Popullor të Mbretërisë SKS, ngjarja është relevante për të gjitha popujt të cilët jetonin në Mbretëri, posaçërisht për shkak të asaj që vetëm 6 muaj pas ngjarjes mbreti Aleksandër vendosi diktaturë personale.



#### Qëllimet

Njohja me atmosferën politike në Mbretërinë SKS të viteve të 20-ta të shek. XX, veçanërisht me raportet e ndërsjella të regjimit dhe politikanit kryesor kroat Stjepan Radiq. Me anë të analizës kritike të burimeve të përcaktohen arsyet e mundshme të atentatit në Kuvendin Popullor dhe të sqarohet arsyet e reagimeve kontroverse të asaj ngjarjeje.



#### Rezultatet e mësimit:

- Nxënësit do të njihen me një pjesë të atmosferës politike në Mbretërinë SKS, veçanërisht me veprimin politik të Stjepan Radiqit ndaj regjimit sundues dhe anasjelltas.

- Nxënësit do të zhvillojnë aftësi të analizimit të burimeve fotografike, aftësi për të bërë vlerësime personale dhe mendim kritik, prezantim kreativ dhe grafik të rezultateve.

- Nxënësit do të zhvillojnë ndjeshmëri, ndjeshmëri shoqërore dhe do të shohin se sa emocionet mund ta forcojnë anën kontroverse të ngjarjeve.



## Udhëzime për mësime

### Pjesa 1: Vrasja në parlament dhe shkaqet (pse u vra Stjepan Radiq?)

Hapi 1 – Pas hyrjes së shkurtër (varësisht nga dijet paraprake të nxënësve), mësime të çiftëve të nxënësve do t'u ndajë 6 tituj gazetash. Detyra e nxënësve është që ato 6 tituj t'i ndajnë sipas shkallës emotive.

Hapi 2 – Mësime të ndan nxënësit në 4 grupe dhe ua jep burimet me pyetjet për analizë. Burimet kanë të bëjnë me arsyet e mundshme për vrasjen. Duhet t'i analizojnë dhe t'i përgjigjen pyetjes kyçe.

Hapi 3 – Secili grup e prezanton përgjigjen për pyetjen e vet kyçe. Në përputhje me përgjigjet mësime të ndan nxënësit dhe bëjnë listën e arsyeve të atentatit dhe i shkruajnë në tabelë.

Hapi 4 – Nxënësit i shkruajnë të gjitha shkaqet në letër dhe u japin formën e diamantit.

Hapi 5 – Diskutim i shkurtër për rëndësinë e shkakut.

### Pjesa 2: Reagimet për vrasjen (cila është arsyeja e reagimeve kontroverse për vrasjen e Stjepan Radiqit?)

Hapi 1 – Mësime të ndan nxënësit në 8 grupe dhe ua shpërndan burimet. Secili grup ka rol të veçantë të personit i cili ka vështrim personal për vrasjen.

Detyra për secilin grup: Nga këndvështrimi i rolit tuaj, përgatisni deklaratë si reagim i atentatit dhe vdekjes së Stjepan Radiqit.

Hapi 2 – Nxënësit (një përfaqësues i secilit grup – rol) i prezantojnë deklaratat (reagimet) e tyre për vrasjen dhe vdekjen e Stjepan Radiqit.

Hapi 3 – Një diskutim i përgjigjet pyetjes kyçe:

Cila është arsyeja kryesore e reagimeve kontroverse për vrasjen e Stjepan Radiqit?



90  
minuta

**Kontekstualizimi**

Më 1 dhjetor 1918 u shpall shteti i parë i përbashkët i sllavëve të jugut – Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Slovenëve. Politikani kryesor mes kroatëve ishte Stjepan Radiq, i cili me qëndrimet e tij për rregullim republikan, barazi nacionale dhe drejtësi sociale ishte opozitë reale ndaj regjimit sundues monarkist. Edhe pse në zgjedhjet parlamentare fituan numër të rëndësishëm të mandateve, deri në vitin 1925 ndjekësit e Radiqit abstenojnë nga puna e parlamentit. Radiqit në disa raste u burgos. Në vitin 1925 heq dorë nga idetë republikane, e pranor regjimin dhe shkurtimisht vepron në qeveri si ministër i arsimit. Në vitin 1927 krijohet koalicioni i HSS-së dhe Partisë së Pavarur Demokratike të Svetozar Pribiçevićit e cila përfaqësonte opozitë mjaft serioze në regjimin sundues.

Renditi ballinat e gazetave sipas ngarkesës emocionale të teksteve të ballinave! Komentojë origjinën (regjionin) e ballinave me më tepër ngarkesë emocionale?

Gjakderdhje e tmerrshme në Kuvendin Popullor	U derdh gjaku	Vrasje e Pavle Radiqit dhe Dr. Bashariçekut
		
<p>"Novosti" – botim i veçantë i 20 qershorit 1928 "Novosti" ishte gazetë e pavarur ditore kroate</p>	<p>"Jutarnji list" i datës 21 qershor 1928. "Jutarni list" ishte gazetë e pavarur ditore nga Zagrebi që u botua nga vitit 1907 deri në vitin 1941</p>	<p>"Politika" e 21 qershorit 1928. "Politika" – gazetë ditore që botohej në Beograd që nga vitit 1904.</p>
Vrasje e tmerrshme në Kuvend	Ditë e përgjakshme në parlament	Manipulojnë me gjakun e njerëzve
		
<p>"Novosti", 25 qershor 1928. <a href="http://dazg.chez.com/flashback_6.htm">http://dazg.chez.com/flashback_6.htm</a> 25 May 2012.</p>	<p>"Slovenec", gazetë e përditshme politike sllovene <a href="http://www.dlib.si/browse/besedila/1">http://www.dlib.si/browse/besedila/1</a> 25 May 2012.</p>	<p>"Domoljub", dyjavore sllovene me përmbajtje edukative dhe zbatimëse. <a href="http://www.dlib.si/browse/besedila/1">http://www.dlib.si/browse/besedila/1</a> 25 May 2012.</p>

## Ora 1

Vrasja në parlament dhe shkaqet e saj

## Hapi 2 – Grupi A

Nxënësit ndahen në katër grupe dhe u jepen burimet

### Burimi 1

**Në fjalimin e Stjepan Radiqit, në sesionin e Kuvendit Kombëtar të 24 nëntorit 1918, kur zhvillohej diskutimi për bashkimin e Shtetit të SKS me Mbretërinë e Serbisë dhe Malit të Zi, ne mund ta shohim qëndrimin fundamental politik të Radiqit:**

Ju zotërinj, aspak nuk shqetësoheni që fshatari ynë në përgjithësi, e posaçërisht fshatari kroat, nuk dëshiron të dëgjoj asgjë për mbretin dhe perandorin, e gjithashtu as për shtetin që i imponohet me forcë (...) Por e di gjithmonë që kroatët nuk do t'i përfitoni për këtë, nuk do t'i përfitoni sepse e tërë bota fshatare kroate është gjithashtu kundër centralizimit tuaj ashtu siç është kundër militarizimit, gjithashtu për republikë si edhe për marrëveshje popullore me serbët (...) Fshatari ynë kroat, që përbën nëntë të dhjetat të popullit kroat – në luftë u bë njeri i plotë, dhe kjo do të thotë ai më nuk do t'i shërbejë askujt, nuk do jetë rob i askujt, as të huajit as 'vëllait' (...) Por dëshiron që në këtë kohë të madhe shteti të rregullohet me themel të lirë republikan dhe në mënyrë të drejtë njerëzore (sociale).

*Stjepan Radić: Politički spisi, Zagreb, 1971., str.323-335*

### Burimi 3

**Radiq në periudhën nga 1919 deri më 1925 disa herë është burgosur për shkak të qëndrimeve të tija republikane dhe për shkak të kritikës së hapur ndaj shtetit dhe regjimit. Burimi vijues flet për burgosjen e tij në vitin 1925:**

Të gjitha tubimet e partisë janë ndaluar, arkivi është konfiskuar, ndërsa është lëshuar edhe urdhëresa për arrestim të Radiqit dhe disa udhëheqëseve të partisë. Dekreti mbështetej në konstatimin se partia, duke iu bashkuar internacionales fshatare, u bë pjesë e Internacionales së Tretë Komuniste (të cilën kroatët çdoherë e kontestojnë), që mbante lidhje të paligjshme me Komitetin Revolucionar Maqedonas dhe që anëtarët e saj janë përgjegjës për propagandën subversive në ushtri. Pesë udhëheqës të partisë janë arrestuar, por zotëri Radiq ka arritur që në kohë t'i ik arrestimit dhe është gjetur më vonë si fshihet në mënyrë të turpshme në një qosh muri, në banesën e nipit të tij.

*Britanci o Kraljevini Jugoslaviji, uredio: Ž. Avramovski, Zagreb, 1986, str.311.*

### Burimi 2

**Stjepan Radiq në pllakat propagandues**



Teksti i pllakatit:  
Vetëm Republika është shprehje e plotë e sundimit të lirë popullor

*file:///D:/multimedija/program/pov8/032-1.htm (15 May 2012)*

### Pyetje për grupin A:

1. Çfarë shteti, që para bashkimit, proklamonte Radiqi:
  - a) në kuptim të rregullimit shtetëror (politik),
  - b) në kuptim të raporteve nacionale me sllavët tjerë të jugut dhe
  - c) në kuptim social?
2. Pse u arrestua Radiq në vitin 1925?

### Çështja kyçe për grupin A:

Pse dhe në cilën mënyrë regjimi përpiqej ta pamundësonte veprimin politik të Radiqit?


**Burimi 1**

**Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare  
1920-1927 në Mbretërinë e SKS**

Viti dhe partitë	1920	1923	1925	1927
Partia demokratike	92	51	37	61
Partia popullore radikale	91	108	143	112
Partia komuniste	58			
Partia (popullore republikane)	50*	70*	67	61
Partia Fshatare			21	22
Demokratët e pavarur				
Partitë tjera kroate	6	1	0	2
Partitë tjera	122	84	47	57

\*Përfaqësuesit e zgjedhur të PRFK-së nuk morën pjesë në punimet e kuvendit në vitin 1920 dhe 1923.

Sipas të dhënave të rezultateve të zgjedhjeve parlamentare, janë paraqitur në mënyrë grafike raportet numerike në kuvend



PRFK/PFK  
Partia Radikale  
Partitë e tjera

Partia Demokratike  
Partitë tjera kroate

**Pyetje për grupin B:**

Bëni pyetje për analizën e rezultateve të zgjedhjeve!

**Pyetja kyçe për grupin B:**

Çfarë rezultatesh kishte në zgjedhje partia e Radiqit?

## Burimi 1

**Stjepan Radiq në kuvendin në Hlebine më 5 dhjetor 1927 e tha këtë:**

Ne e kemi lidhur korrupsionin. Edhe nëse Partia jonë Fshatare nuk ka bërë asgjë para botës, përveç që tregoi se shteti ynë ka fytyrë si e juaja, se është shtet i popullit të drejtë, që nuk i durojmë hajdutët, kjo është gjë e madhe. Mund a kisha paguar me jetë, e ndoshta edhe do ta paguaj. Unë kam pranuar letra në të cilat më shkruajnë: Do të të vras! Publikisht kanë thënë: Pashiq ka vdekur, Radiq duhet të vritet. Nëse nuk e kemi për këtë njeriun tonë, do të gjejmë kroat.

*Gazeta "Dom", 19.01.1927*

*"Dom" ishte organi i partisë së Radiqit që nga vitit 1904*

## Burimi 3

**Gazeta "Jedinstvo" të cilën e inicioi dhe financoi kryetari i Qeverisë Veljo Vukiçević në qershor 1928, në numrin e 17.06.1928 në mënyrë të hapur i kërcënohej me vrasje Radiqit dhe Pribiçevićit.**

Megjithatë, nëse mendoni se dikush e rrënon nga brenda vendin, atëherë detyra e vetme ishte dhe mbetet që në ditën e njëjtë të vriten edhe Svetozar Priviçević në Beograd edhe Stjepan Radiq në Zagreb.

## Burimi 2

**Propozimi i Radiqit për rishikim të kushtetutës dhe rirregullim të shtetit:**

Duhet të bëhet organizimi i tre deri në katër zonave, të cilat duhet të mbështeten në parimet ekonomike, sociale, arsimore dhe gjeografike. E para, zona e Adriatikut – Danubit në të cilën do të bënin pjesë të gjitha hapësirat qendrore-perëndimore pa Slloveninë, por me Malin e Zi. Zona e dytë do të ishte Serbia-Morava (Serbia Qendrore), zona e tretë Serbia Jugore, dhe zona e katërt – Sllovenia. Secili regjion do të kontrollonte gjithçka sa i përket ekonomisë, kulturës dhe kujdesit social. Në Beograd do të mbetet legjislatura dhe ekzekutivi në shkallë të gjerë, ndërsa të gjitha ligjet që e rregullojnë jetën dhe bashkëpunimin do të kalonin në zona".

*Hrvoje Matković: Povijest HSS-a, Naklada Pavičić, Zagreb, 1999, str.248. (Matković citira Radića prema listu Riječ, 134/13.VI. 1928.)*

## Burimi 4

**Sllobodan Jovanović thekson se politikanët serbë besojnë se federalizmi është i rrezikshëm për unitetin shtetëror:**

Në luftën e tyre shekullore për shtet dhe pavarësi, serbët e fituan kultin e vërtetë të idesë shtetërore dhe mjaft ishte që t'u thuhet se federalizmi mund ta sjellë në pikëpyetje unitetin shtetëror, që ata të bëhen menjëherë kundërshtarë"

*Slobodan Jovanovic, Jugoslovenska misao u proslosti i buducnosti, Beograd 1939, str 3.*

**Pyetje për grupin C:**

1. Pse Radiq pranonte letra kërcënuese?
2. Çka propozonte Radiq për rirregullimin e vendit dhe pse konsiderohej që e rrënon shtetin nga brenda?

**Pyetja kyçe për grupin C:**

Interesat e kujt i kërcënonte Radiq me kritikën dhe propozimet e tija dhe çfarë kërcënimesh merrte për këtë?

## Ora 1

Vrasja në parlament dhe shkaqet e saj

## Hapi 2 – Grupi D

Nxënësit ndahen në katër grupe dhe u jepen burimet

### Burimi 1

#### Përafërsisht para atentatit

**“Punisha Raçiq:** ... Deklaroj para të gjithë juve se asnjëherë interesi serb, kur nuk krisin pushkët dhe topat, nuk janë vënë në rrezik sesa tani... (zhurmë) Dhe zotërinj, si serb dhe deputet, kur shoh rrezik ndaj kombit dhe atdheut tim, hapur them se do të përdor edhe armë të tjera, të cilat duhet t'i mbrojnë interesat e serbizmit... (zhurmë e madhe dhe protestë te opozita)

**Svetozar Pribiçević:** A dëshironi që në Londër të dëgjohet se këtu kërcënoheni me armë?

**Dr. Pernar:** I plaçkitët bejlerët!

**Punisha Raçiq** (zbret nga foltorja): Kërkoj, zotëri kryetar, t'i dënoni ose unë do ta dënoj (zhurmë dhe protesta të zhurmshme). Kushdo që do të përpiqet ta vendos veten mes meje dhe Pernerit, do të vritet! (zhurmë e madhe). Në atë moment ai vërtetë e nxori revolverin. Ministri Vujiçiq i cili ishte i ulur pranë tij në tavolinën e ministrave e kap për dore me qëllim që ta pengojë të gjuajë. Në të njëjtin moment kërcen Obradiviçi, por edhe Raçiqi, fizikisht njeri mjaft i fuqishëm, ia shtyn dorën Obradoviçit dhe krisma e tmerrshme nga pistoletat jehoi në sallë...

*Josip Horvat: Politička povijest Hrvatske 2 str.342-343 (prema novinskom izvještaju)*

### Burimi 2

“Zotëri Stjepan Radiq atë ditë ishte plotësisht i qetë. Asnjë ndërhyrje nuk u dëgjua nga goja e tij... Pavle Radiq gjithashtu ishte i qetë... Vetëm z. Grangja dhe z. Pernar atë ditë tragjike ishin temperamentë dhe fortë të revoltuar për shkak të kërcënimeve me vrasje... E tërë atmosfera ishte e plotë me elektricitet. Të gjithë e parandienin fatkeqësinë, por askush nuk mendonte se do të ndodhë aq shpejtë tragjedia më e madhe që nga themelimi i këtij shteti”.


*‘Politika’, n. 7236, 24 qershor 1928..*

### Burimi 3

Politika, nr. 7232, 21 qershor 1928, në faqen 7, nën titullin **Raçiq shndërrohet në**, e boton fjalinë e fundit para se Punisha Raçiq të del nga sallat e Kuvendit duke e mbajtur pistoletën në duart e tij: Ai qau: **“Roftë Serbia! Roftë Serbia e madhe”**.

### Burimi 4

#### Rikonstruksioni i atentatit i përpiluar sipas të dhënave të gazetës “Politika”, nr.. 7236, të datës 26 qershor 1928



*Z. Kulundžić: Atentat na Stjepana Radića, Zagreb, 1967, f. 374.*

#### Pyetje për grupin D:

1. Çka i shërbeu Punisha Raçiqit si arsye për atentatin?
2. Me cilat fjalë u përshkrua atmosfera në Parlament përafërsisht para atentatit?
3. Çka mendon, a kaloi me paramendim Raçiq gjatë fjalimit të tij nga vendi i tij prapa foltores?


#### Pyetje kyçe për grupin D

A ka mundësi të nxirret përfundim nga vet ngjarja për shkaqet e atentatit?

**Ora 1**  
Vrasja në parlament dhe  
shkaqet e saj

*Pasi që secili grup e kryen detyrën e vet, mësime të mësuara në tabelë i shkruan përgjigjet e pyetjeve kyçe të secilit grup. Sipas përgjigjeve bashkërisht bëni listë të 10 shkaqeve të atentatit.  
Nxënësit shkaqet e përmendura i shkruajnë veças në kartonë.  
Detyrë për nxënësit: Renditni shkaqet e mundshme në "diamant" sipas rëndësisë!*

**Diamanti**





## Ora 2

### Reagime për atentatin

Nxënësit ndahen në 8 grupe (role) nga 3-4 nxënës, dhe u shpërndahen burimet.

**Detyra:** Në pajtim me "rregullat" përpiloni një deklaratë si reagim ndaj atentatit dhe vdekjes së Stjepan Radiqit.

#### Grupi 1

##### Anëtarët e Partisë Kroate të Drejtësisë

Milefi i arsyeshëm i tërë publikut kroat për vrasjen e përfaqësuesve popullorë kroatë në parlamentin e Beogradit erdhi në shprehje të plotë si në të gjitha viset kroate edhe në Zagreb në demonstratat e djeshme. Milefi ishte i pakufishëm, dhe është çudi e vërtetë që nuk kishte pasoja të rënda përveç njëzet të plagosur, të cilët e pësuan gjatë demonstratave...

Artikulli është nga gazeta e Partisë Kroate të drejtësisë "Hrvat" në rubrikën Kronika e Zagrebit



[http://dazg.chez.com/flashback\\_6.htm](http://dazg.chez.com/flashback_6.htm) (25.05.2012).

#### Grupi 2

##### Sekula Drljeviq

Sekula Drljeviq, person kontrovers historik në Mal të Zi, në jetën parlamentare të Mbretërisë së SKS ishte njëri prej liderëve të Partisë Federaliste Malazeze, ndërsa në zgjedhjet e vitit 1927 u zgjosh si deputet në listën e Partisë Fshatare Kroate. Në *Shkrimet politike* të tija me titull *20 qershor 1928* mes tjerash e shpreh edhe vështrimin e tij për atentatin:

"Nga pusia, sipas planit të përcaktuar paraprakisht, është kryer krimi i vrasjes ndaj Udhëheqësit dhe Mësuesit të popullit kroat dhe ndaj shokëve të tij. Udhëheqësi vdiq në momentin kur populli kroat i mbështeste të gjitha shpresat e tija në fitoren e tij dhe u bë viktimë e krimit në momentin kur keqbërësit vetëm në vdekjen e tij i shihnim mundësitë e fitores mbi popullin kroat".

#### Grupi 3

##### Ivan Meshtroviq

Ivan Meshtroviq, artist i njohur i cili deri në vitin 1918 merrej me politikë dhe ishte anëtar i Këshillit Jugosllav.

"Një ditë pas atentatit e takova gruan e admiralit Stankoviç. Ajo m'u afrua dhe më tha në frëngjisht:

-Këta serbët jo vetëm që janë primitivë, por edhe janë keqbërës të lindur dhe hajna të pasinqertë.

Më pas më tregoi çka i tha burrit të saj komanduesi i vendit, gjenerali Trnokopoviç, kur admiralit Srankoviç tha që është turp të gjuash në përfaqësuesit e popullit, edhe atë në mes të Kuvendit Popullor, sepse kjo mund të ketë jo vetëm pasoja të brendshme por edhe pasoja të jashtme. Në vend të përgjigjes, gjenerali e pyeti admiralin:

-A është Shtipica (Stjepan Radiq) i vdekur?

-Nuk është i vdekur Stjepan Radiq – u përgjigj Stankoviç – por, sipas lajmeve, vetëm është plagosur rëndë, ndërsa të vdekur janë nipi i tij Pavle Radiq dhe Gjiro Basariçek.

-Oh i dashur, sa dobët paska gjuajtur – u përgjigj tani Trnokopoviç dhe shtoi – pasojat do të jenë që do të duhet të gjuajë sërish, nëse mbijeton".

*Ivan Meštrovic: Uspomene na političke ljude i događaje, Zagreb 1993.*

#### Grupi 4

##### Svetozar Pribiçeviq

Svetozar Pribiçeviq, politikan serb nga Kroacia dhe Radiçev partner koalicioni në librin e tij "Diktatura e mbretit Aleksandër" për Punisha Radiqin shkroi:

"I lindur në Mal të Zi, por i rritur në Serbi, ku e kaloi tërë jetën. Pashiq e përdorte për punët e besueshme në Maqedoni dhe Shqipëri. Ishte komit në Maqedoni dhe pas bashkimit bënte pjesë në organizatën çetnike... iu bashkua Partisë Radikale. Llogaritej si mbështetës i idesë së Serbisë së Madhe. Ai e organizoi vrasjen e Radiqit sipas urdhrat të lartë që e kishte marrë më parë..."

*Dr. Sekula Drljević, Politička misao; izabrana djela, uvodna studija, izbor tekstova i dokumentarnih priloga Danilo Radojević, Podgorica 2007. godina, str.296.*

## Ora 2

### Reagime për atentatin

Nxënësit ndahen në 8 grupe (role) nga 3-4 nxënës, dhe u shpërndahen burimet.

**Detyra:** Në pajtim me "rregullat" përpiloni një deklaratë si reagim ndaj atentatit dhe vdekjes së Stjepan Radiqit.

#### Grupi 5

##### Qytetar i Zagrebit

Varrimi i Stjepan Radiqit, 12 gusht 1928



<http://www.daz.hr/web/cache/preview/fdb5568d642fbae8f7cae1c3049c69fa.jpg> 15 May 2012.

#### Grupi 7

##### Gazetari i huaj

Më 23.06.1928 gazeta Australiane The Mail (nga Adelaide) shkroi për trazirat në Zagreb pas atentatit në Kuvendin Popullor, për orën policore që është vendosur për këtë arsye në Zagreb, por edhe/...

"Ekziston shumë gjak i keq mes kroatëve dhe serbëve në Mbretërinë Jugosllave. Kjo solli deri te trazirat në Zagreb (kryeqyteti i Kroacisë) kur u morr vesh që Stjepan Radiq (politikan kroat dhe kryetar i Partisë Fshatare) është plagosur, ndërsa Pavle Radiq (nipi i tij) është vrarë nga ana e Raçiqit (deputet tjetër) gjatë seancës së Kuvendit Popullor".

Machester Guardian e datës 10.08.1928 shkruan për vdekjen e Stjepan Radiqit. Autori i artikullit në mënyrë kritike bën vështrimin e mentalitetit ballkanik në të cilin masat e ndjekin udhëheqësin duke e konsideruan Radiqin si udhëheqës të suksesshëm popullist. Theksohet gjendja mjaft e tendosur mes kroatëve dhe serbëve pas atentatit në kuvend dhe përfundohet:

"Kroatët kërkojnë shkëputje. Me Radiqin e vrarë do ta kërkojnë më shumë se kurdoherë... Jugosllavia i filloi ditët më të zeza të historisë së saj të shkurtër. Askush nuk mund të thotë a do të dal si komb i shëruar apo i thyer".

<http://trove.nla.gov.au/ndp/del/article/58553487> 20 May 2012.

#### Grupi 6

##### Anëtar i Partisë Radikale Serbe

"Në ndërkohë në Beograd nuk kushte thuajse asnjë manifestim të pikëllimit dhe kroatët vlerësuan se reagimi në ngjarjet historike në atë qytet mbi të gjitha është joadekuat. **Mediet qeveritare, edhe pse e gjykonin krimin, e theksonin edhe sjelljen provokuese të opozitës.** Vlerësimet e këtilla nuk kontribuuan për qetësimin e situatës. Pasoja aspak më të vogla nuk kishte as toleromi qeveritar i gazetës "Jedinstvo" që kishte tendenca skajshmërisht radikale, i cili në numrin e parë, të botuar disa ditë para krimit, synonte mënjanimin e z. Radiqit dhe Pribiçeviqit".

*Izveštaj britanskog diplomate H.W. Kennarda, Britanci o Kraljevini Jugoslaviji, Ž. Avramovski, Zagreb, 1986,*

#### Grupi 8

##### Zëdhënësi i Qeverisë së Mbretërisë së SKS

Shpallja e Qeverisë së re e bërë në seancën e Kuvendit Popullor më 03.08.1928:

"Ngjarja e 20 qershorit të vitit vijues, e cila meriton dënim më të madh dhe e cila na mori dy shokë të dashur dhe më shumë prej tyre i plagosi, nuk guxon të jetë arsyeja që ta ndërpresim bashkëpunimin e gjertanishëm ligdhënës, i cili për shtetin tonë është aq i nevojshëm. Kjo ngjarje e pikëlluar është e veçuar dhe personale dhe nuk guxon të përgjithësohet. Është padrejtësi e madhe kur grupet të tëra parlamentare ose, çka është ende më e keqe, pjesë e tërë e popullit akuzohet pa asnjë arsye si vepër me të cilën nuk ka asgjë të përbashkët dhe të cilën e vajtojnë dhe e dënojnë si edhe e tërë bota e kulturuar. Ashpërsimi i këtillë i raporteve mund vetëm të jetë i dëmshëm".

*"Politika", nr. 7276, 3 gusht 1928, faqja 1*

Nxënësit në bazë të roleve (nga një përfaqësues i secilit grup) i prezantojnë mendimet e tyre për atentatin dhe vdekjen e Stjepan Radiqit.

**Pyetjes kyçe** duhet t'i përgjigjen nëpërmjet diskutimit:

Cili ishte shkaku kryesor i reagimeve kontroverse për vrasjen e Stjepan Radiqit?